



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.17.6-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AGJENCISË KOSOVARE TË
PRONËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Agjencisë Kosovare të Pronës në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga, Astrit Bllaca (Udhëheqës Ekipi), dhe Arta Kryeziu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	19
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	22

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Drejtorin ekzekutiv dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 04 dhjetor 2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyrat financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Agjencisë Kosovare të Pronës (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar).*

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Agjencisë Kosovare të Pronës kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Kontrollat efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të behët në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar. Kjo ka siguruar që buxheti të ekzekutohet në pajtueshmëri me planin e rrjedhjes së parasë.

Më gjithë progresin e arritur, ne vërejtëm disa fusha në të cilat nevojiten kontrole shtesë. Kjo përfshinë kryesisht planifikimin e buxhetit dhe evidentimin e të dhënave të raportuara, si dhe menaxhimin e pagave dhe mëditjeve, për të mundur trajtimin e barabartë të të gjithë të punësuarve. Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët kontrole shtesë nevojiten edhe pikën e kontrollit në procesin e pagesave.

Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm janë si në vijim:

Drejtori ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Pronës duhet të sigurojë se:

- Me rastin e planifikimit të buxhetit, janë bërë analiza të hollësishme dhe janë identifikuar nevojat reale të shpenzimeve, përfshirë edhe kategorizimin e tyre. Me tutje, të siguroj se të gjitha shpenzimet janë regjistruara në kategoritë ekonomike adekuate; dhe
- Do të rishqyrtoj vendimet e marra dhe të konsiderojë mundësinë që donacionet e dhëna për paga dhe mëditje si dhe sigurime shëndetësore të mbulojnë gjithë stafin e AKP-së. Gjithashtu të siguroj se pagesat e sigurimeve shëndetësore kanë bazë të qëndrueshme ligjore.

Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallen deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë raporti më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

AKP, ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)**.

¹ Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në memon tonë të planifikimit të auditimit, e datës 4 dhjetor 2013, është identifikuar një rrezik domethënës në PVF lidhur me mbylljen e avanseve. Rreziku i anomalive materiale, mund të rezultojë me një opinion të modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziku i anomalive që ne kemi identifikuar në fazën e planifikimit në lidhje me mbylljen e avanseve nuk ka ndodhur. Kjo në sajë të veprimit specifik që ka marrë Drejtori ekzekutiv për të adresuar rrezikun. Në veçanti, AKP ka ndërmarrë veprime gjithëpërfshirëse për të identifikuar dhe mbyllur të gjitha avanset e hapura të vitit 2013.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF - Nr 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij; dhe
- Kërkesat e rregullores 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike dhe rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore;
- Nëse PVF-të, janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF; dhe
- Nëse PVF-të janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 20 dhjetor 2013, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrimi

Përveç hartimit të PVF-ve, nga AKP, kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportin vjetor të punës për vitin 2012;
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit;
- Raportet mbi obligimet e papaguara;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit; dhe
- Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

AKP kishte ndërmarrë disa veprime për t'i adresuar rekomandimet e dhëna dhe për të siguruar përmirësimin e fushave kryesore të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Ky proces duhet të vazhdoj edhe më tutje, duke aplikuar masa dhe veprime konkrete për të adresuar edhe rekomandimin e mbetur.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të AKP-së kishte rezultuar në dy rekomandime. AKP kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2013, një rekomandim është adresuar plotësisht, ndërsa tjetri ende nuk është adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Lidhur me rekomandimin e pa adresuar ne nuk do të japim rekomandime në këtë kapitull, pasi që ky rekomandim është përsëritur të kapitulli 4.2. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe të rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komitetet e Auditimit.

Menaxhmenti i AKP-së kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Kontrollet efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të behët në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar. Kjo ka siguruar që buxheti të ekzekutohet në pajtueshmëri me planin e rrjedhjes së parasë.

Më gjithë progresin e arritur, ne vërejtëm disa fusha në të cilat nevojiten kontrolle shtesë. Kjo përfshinë kryesisht planifikimin e buxhetit dhe evidentimin e të dhënave të raportuara, si dhe menaxhimin e pagave dhe mëditjeve, për të mundësuar trajtimin e barabartë të të gjithë të punësuarve. Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët kontrolle shtesë nevojiten edhe pikën e kontrollit në procesin e pagesave.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për AKP-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,782,771	3,498,438	3,333,180	3,388,920	3,382,169
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,782,771	1,782,771	1,734,992	1747,031	1,818,793
Të bartura nga viti paraparak ³ -	0	0	0	11,160	0
Të hyrat vetanake ⁴	0	0	0	0	31,332
Donacionet e jashtme	0	1,715,667	1,598,188	1,630,729	1,532,043

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 1,715,667€, e cila rrjedh nga donacionet të jashtme.

Në vitin 2013, AKP ka përdorur 95% të buxhet final ose 3,333,180€, nivel i cili pothuajse është i ngjashëm me vitin 2012.

Trendi i shpenzimeve ndërmjet viteve është i ngjashëm dhe nxjerr në pah një nivel të vazhdueshëm dhe konsistent të ekzekutimit të buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraparak të bartura në vitin aktual.

⁴ Një pjesë e faturave të planifikuara dhe të mbledhura për Buxhetin e Kosovës në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,782,771	3,498,438	3,333,180	3,388,920	3,382,169
Pagat dhe Mëditjet	957,233	1,895,510	1,850,165	1,841,545	1,768,529
Mallrat dhe Shërbimet	635,028	1,393,082	1,283,694	1,346,226	1,296,549
Shërbimet komunale	96,510	129,185	119,969	131,794	103,729
Subvencionet dhe Transferet	0	6,000	6,000	0	0
Investimet Kapitale	94,000	74,661	73,351	69,355	213,362

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Të pagat dhe mëditjet buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 938,277€ (rritja e buxhetit nga donacionet e jashtme ishte në vlerë 988,820€ dhe reduktimi me vendim të Qeverisë ishte 50,543€). Në këtë kategori AKP kishte arritur të realizoj 98% të buxhetit final;
- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është rritur me vendim të Qeverisë dhe nga donacionet e jashtme në vlerë 758,054€. Realizimi në këtë kategori ishte 92%; dhe
- Te kategoritë investime kapitale dhe shpenzime komunale nuk kishte ndryshime të mëdha në mes të buxhetit fillestar dhe atij final. Realizimi gjithashtu ishte i lartë në 98% të investimet kapitale dhe 93% të shpenzimet komunale. Ndërsa të subvencionet dhe transferet ishte shpenzuar 100% e buxhetit final.

Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimet	2012 Pranimet	2011 Pranimet
Të hyrat	-	34,848	34,848	0	24,455
Donacionet e jashtme	-	1,672,662	1,672,662	1,222,730	1,424,105
Totali	-	1,707,510	1,707,510	1,222,730	1,448,560

Donacionet e jashtme prej 1,672,662€ ishin shfrytëzuar për nevojat e AKP-së. Ndërsa pjesa e të hyrave të inkasuara prej 34,848€ janë bartur në Buxhetin e Kosovës (BK).

Çështja 1 - Planifikimi dhe realizimi i buxhetit - Prioritet i lartë

- E gjetura** Gjatë procesit të planifikimit, AKP ka buxhetuar gabimisht shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve (Blerja e pajisjeve nën vlerën 1,000€) në kategorinë e investimeve kapitale në vlerë 36,667€. Me tutje, AKP nuk ka marrë masa për transferimin e mjeteve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, mirëpo ka procesuar dhe evidentuar blerjen e pajisjeve nga investimet kapitale.
- Gjatë vitit 2014, AKP kishte bërë kërkesë në MF për transferimin e mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, mirëpo MF nuk e kishte aprovuar kërkesën e tyre.
- Rreziku** Planifikimi dhe evidentimi i shpenzimeve në kode jo adekuat shkakton paqartësi në raportimin e shpenzimeve të ndodhura. Kjo ndikon në mbivlerësim e shpenzimeve në një kategori, kundrejt nënvlerësimit në kategorinë tjetër.
- Rekomandimi 1** Drejtori ekzekutiv duhet të siguroj se me rastin e planifikimit të buxhetit, janë bërë analiza të hollësishme dhe janë identifikuar nevojat reale të shpenzimeve, përfshirë edhe kategorizimin e tyre. Me tutje, të siguroj se të gjitha shpenzimet janë regjistruara në kategoritë ekonomike adekuate.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake dhe donacionet e jashtme)

Përshkrimi

AKP gjatë vitit 2013 ka pranuar të hyra në vlerë 1,707,510€ (nga donacionet e jashtme 1,672,662€, ndërsa 34,848€ të hyra nga taksa administrative dhe nga shitja e pasurive).

Donacionet e jashtme rrjedhin nga Qeveria Britanisë, Zvicrës, Norvegjisë dhe SHBA-së. Ato ishin shpenzuar për paga dhe mëditje. Ndërsa të hyrat vetanake janë bartur në Buxhetin e Kosovës.

Ne konkludojmë se të hyrat janë menaxhuar në pajtueshmëri të plotë me Legjislacionin aktual. Po ashtu, regjistrimi dhe prezantimi i tyre në PVF ishte i plotë dhe i saktë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Në këtë fushë të shpenzimeve ne kemi përfshirë të gjitha prokurimet që ndërlidhen me investimet kapitale si dhe ato për mallra dhe shërbime. Ekzaminimet tona audituese kanë përfshirë tërë procesin e prokurimit, duke filluar nga inicimi i aktiviteteve të prokurimit e deri në menaxhimin dhe realizimin e kontratave.

Gjatë vitit 2013, AKP përmes procesit të prokurimit ka realizuar 82 kontrata. Ne, kemi testuar 6 kontrata në vlerë prej 55,328€, si dhe 24 pagesa tjera në vlerë prej 102,191€.

Çështja 2 - Regjistrimi në SIMFK pas pranimit të faturës - Prioritet i mesëm

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se në shtatë raste nuk është ndjekur renditja e duhur e aktiviteteve gjatë procesimit të tyre. Kërkesa për blerje, urdhërblerja, si dhe pranimi mallit janë bërë pas pranimit të faturës. |
| Rreziku | Faturimi për mallra dhe shërbime para se të përcaktohen kërkesat/nejovat, mund të rezultojë që të pranohen mallra të cilësisë dhe sasisë jo të nevojshme. |
| Rekomandimi 2 | Drejtori ekzekutiv duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPD dhe me rregulla të thesarit. |

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne testuam nëntë pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 21,927€. Gjatë testeve të bëra në këtë kategori ne, nuk kemi hasur në ndonjë parregullsi për tu raportuar.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitin 2013 ishte 1,895,510€. Prej tyre janë shpenzuar 1,850,165€ apo 98%.

Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari (SIMFK) dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu kemi testuar mostra, duke përfshirë dosjet e personelit dhe procedurat e rekrutimit të realizuara gjatë vitit 2013. Bazuar në këtë, ne kemi konstatuar së AKP, ka të vendosur sisteme të mira të kontrollit mbi fushën e kompensimeve (pagave dhe mëditjeve), me përjashtim të çështjes së prezantuar në vijim.

Çështja 3 - Mos trajtim i barabartë i të punësuarve - Prioritet i lartë

E gjetura Gjatë testimit të pagave, kemi vërejtur se një pjesë e stafit të AKP-së nuk janë përfshirë në skemën e përfitimit të pagave nga donacionet si dhe përfitimeve tjera nga pagesat e sigurimit shëndetësor. AKP në fund të vitit kishte gjithsej 235 të punësuar, ndërsa vetëm 163 prej tyre kishin përfituar nga donacionet e dhëna për këtë kategori. Vendimi për përfitimin e donacioneve për stafin është marrë në vitin 2008 dhe që nga ajo periudhë ky vendim nuk është rishikuar.

Përveç, pagesës së pagave nga donacionet AKP ka nënshkruar kontratë për sigurim shëndetësor për një vit në vlerë totale 52,229€. Këto lloje të kontratave nuk praktikohen nga organizatat buxhetore deri në miratimin e ligjit i cili rregullon këtë çështje. Përveç kësaj AKP nuk ka arritur të siguroj se pagesat për sigurime shëndetësore mbulojnë gjithë stafin e saj, pasi që një pjesë e tyre janë mbetur jashtë kësaj skeme.

Rreziku Mos përfshirja e të gjithë të punësuarve në skemën e përfitimit të pagave dhe beneficioneve tjera nga donacionet, mund të ndikoj direkt në motivimin e tyre për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara. Kjo me tutje, mund të ketë ndikim negativ edhe në arritjen e objektivave të Institucionit.

Rekomandimi 3 Drejtori ekzekutiv në bashkëpunim me donatorët t'i rishqyrtojnë vendimet e marra dhe të rishikoj mundësinë që donacionet e dhëna për paga dhe mëditje si dhe sigurime shëndetësore të mbulojnë gjithë stafin e AKP-së. Gjithashtu të siguroj se pagesat e sigurimeve shëndetësore kanë bazë të qëndrueshme ligjore.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Shpenzimet për subvencione dhe transfere për vitin 2013 ishin 6,000€.

Bazuar në marrëveshjen e arritur në mes të Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së Financave dhe Grupit Menaxhues Ndërkombëtar në gusht të vitit 2013, këto mjete janë transferuar në llogarinë e Grupit Menaxhues Ndërkombëtar.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur lidhur me menaxhimin e tyre.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Sipas regjistrimit kontabël (SIMFK) vlera neto e pasurive të AKP-së ishte 298,223€, ndërsa pasuria jo-kapitale me vlerë nën 1,000€ ishte 88,489€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Ne kemi konstatuar se AKP kishte menaxhuar pasuritë e veta në përputhje me praktikën e mira menaxheriale dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Zyrtari i pasurive ka bërë azhurnimin e vazhdueshëm të pasurisë, andaj posedon një regjistër të plotë dhe të saktë lidhur me pasurinë që disponon.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

Pasqyra e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2013 ishte 17,880€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014.

Gjatë vitit 2013, AKP ka raportuar obligime të papaguara në pajtim me kërkesat e rregullores financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore dhe në pajtim me rregulloren MF - Nr 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka përgatitur planin vjetor të auditimit, i cili ka përfshirë fushat të cilat paraqesin rrezik me të lartë. Të gjitha auditimet e planifikuara, gjithsej nëntë, ishin realizuar gjatë vitit 2013.

Pas pranimit të raporteve të auditimit të brendshëm, menaxhmenti kishte marrë masat e nevojshme për të adresuar çështjet e ngritura. Kjo i ka mundësuar menaxhmentit që të merr siguri në lidhje me funksionimin efektiv të kontrolleve, përgjatë të gjitha proceseve të rëndësishme financiare.

Ne i kemi analizuar këto raporte dhe kemi vërejtur se raportet janë të cilësisë së duhur, duke nxjerr konkluzione dhe rekomandime të dobishme për menaxhmentin e AKP-së.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4.5.1. Prokurimi	Me rastin e planifikimit të buxhetit, të bëhen analiza të hollësishme, të identifikohen nevojat reale dhe të bëhet klasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike adekuate.			Nuk janë marrë masat e duhura.
4.6.1. Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Në bashkëpunim me donatorët ka siguruar dokumentet mbështetëse për veturat e pranuar dhe ka shfrytëzuar ato informata për vlerësimin dhe regjistrimin e veturave në regjistrat përkatës.	Po		